



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Drejtoria Komunale e Arsimit
Prishtinë
Nr.97, datë 05.06.2017

Në bazë të nenit 5, shkronja b) të Ligjit Nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës dhe në bazë të Ligjit mbi Edukimin Parashkollor Nr. 02/L-52:

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT (DKA)

SHPALL KONKURS

PËR REGJISTRIMIN E FËMIJËVE NË INSTITUCIONET PARASHKOLLORE PUBLIKE TË KOMUNËS SË PRISHTINËS PËR VITIN EDUKATIV 2017/2018

Drejtoria e Arsimit shpall konkurs për këto vende të lira në institucionet parashkollore publike të Komunës së Prishtinës:

Vendet e lira në Institucionet parashkollore 2017/18

Grup moshë	IP. Dielli	IP. Yllkat	IP. Fatosat	IP. Xixëllonjat	IP. Buzëqeshja	IP. Ardhmëria	IP. Lulevera	IP. Gëzimi Ynë
1-2 vjeç	36	20	36	12	10	14	22	45
2-3 vjeç	2	10	9	9	19	0	5	16
3-4 vjeç	0	24	0	1	8	0	8	18
4-5 vjeç	6	4	0	1	0	4	0	9
5-6 vjeç	0	0	6	0	0	2	1	17
3-6 vjeç								7
Gjithsej	44	58	51	23	37	20	36	112

Konkursi do të jetë i hapur prej datës **05 qershor, deri më 16 qershor 2017.**

Aplikimi dhe dorëzimi i dokumenteve bëhet në Institucionin Parashkollor përkatës çdo ditë pune prej orës 09:00 deri në ora 15:00.

Shpallja e rezultateve bëhet më datë **1 korrik 2017**, në institucionet parashkollor përkatës, si dhe në web-faqen e Komunës së Prishtinës.

Regjistrimi i fëmijëve në Institucionet Parashkollore bëhet bazuar në Kriteret e Regjistrimit të përcaktuara nga Drejtoria Komunal e Arsimit (DKA), sipas vendimit 03 nr. 170, dt. 15.06.2015.

Të gjithë të pakënaqurit me rezultatet e regjistrimit mund të ushtrojnë **ankesë në Institucionin Parashkollor** përkatës dhe nëse sërish janë të pakënaqur me vendimin e institucionit, atëherë mund të ushtrojnë ankesë në DKA. **DKA nuk e shqyrton asnjë ankesë nëse pala paraprakisht nuk ka përgjigje me shkrim në ankesën e ushtruar në komisionin e Institucionit Parashkollor përkatës.**

Prishtinë, 5 qershor 2017.